

Pyetje

Njoftimi dhe konsultimi publik

Përgjigje

Agjencia Kombëtare e Diasporës në kuadër të njoftimeve dhe konsultimeve publike ka ndjekur dhe ka zbatuar diaspozitat ligjore në zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Agjencia Kombëtare e Diasporës në përputhje me misionin dhe fushën e përgjegjësisë institucionale në cilësinë të institucion varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është angazhuar në proceset e ndryshimeve ligjore dhe Grupet e Punës ngritur për këtë qëllim, si më poshtë:

1. PROJEKTLIGJ “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.16/2018 “PËR DIASPORËN”, I NDRYSHUAR”

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka qenë pjesë e Grupit të Punës për hartimin e aktit: *Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar* me institucion nismëtar Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme”.

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, vjen si rezultat i miratimit të vendimit nr.81, datë 09.02.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për Diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i përkiste Ministrit të Shtetit për Diasporën.

Në këto kushte, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i lindi detyrimi për të bërë një analizë të kuadrit ligjor në fuqi për çështjet e diasporës, duke mbajtur në konsideratë politikën shtetërore dhe objektivat e kësaj ministrie për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Në përfundim të kësaj analize, u vlerësua rishikimi i ligjit nr.16/2018, “Për diasporën” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Kohëzgjatja e konsultimit publik ishte 20 ditë pune, duke filluar nga data 4 mars 2024 deri më 29 mars 2024. (Linku <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/707>)

Palët e interesit të përfshira:

Palët e interesuara që kanë dhënë komente në konsultimet publike: 1. Organizata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” (ODPSHL) 2. Dhoma e Biznesit të Diasporës (DHBD) 3. Këshilli Kombëtar i Diasporës (KKD) 4. Qendra e Botimeve të Diasporës (QBD) 5. Esmeralda Arifi 6. Anila Hyka

Smorgrav 7. Etmond Guri - Anëtar i Bordit Drejtues të Diasporës Shqiptare në Greqi; Ish-kryetar i Federatës së Shoqatave Shqiptare në Greqi; Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Kulturore dhe Artistike “Lushnja” në Greqi; Përgjegjës i Departamentit të Drejtave të Njeriut dhe Integritetit pranë Organizatës “JETA”; Aktivist me pjesëmarrje në shumë institucione në Greqi, siç anëtar në Këshillin e Kontrollit Social në Radiotelevizionin Kombëtar të Greqisë – ERT; Anëtar i Këshillit të Integritetit të Emigrantëve në Bashkinë e Athinës nga viti 2015 – 2023, etj.

Projektligji është depozituar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në date 28 mars 2025 dhe mund të konsultohet në linkun: <https://parlament.al/dokumentacioni/aktet/a2ec9030-ae5c-4329-8134-0607bf48e9f3>

Statusi : në të cilin ndodhet projektligji është në proces.

2. VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.148 DATË 6.03.2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka qenë pjesë e Grupit të Punës në kuadër të përgatitjes së ndryshimeve nënligjore finalizuar me miratimin e **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.148 datë 6.03.2025** “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.104 datë 28.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrimit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë.

Statusi: përfunduar/ miratuar

3. VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.636 DATË 10.10.2024

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka qenë pjesë e Grupit të Punës në kuadër të përgatitjes së ndryshimeve nënligjore finalizuar me miratimin e **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.636 datë 10.10.2024** “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.443 datë 26.06.2019 “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.

Statusi: përfunduar/ miratuar

Për sa më sipër, i gjithë procesi është mundësuar dhe përmbyllur përmes miratimit të **Udhëzimit të Përbashkët nr.21 datë 22.10.2024** të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e procedurës së përzgjedhjes së arsimtarëve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë autorizimit dhe lidhjes së kontratave individuale me arsimtarin dhe të monitorimit të mësimdhënies të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë”.

4. STRATEGJIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Diasporës është duke punuar ngushtësisht me kooordinatorët shtetërorë dhe partnerë vendas e të huaj në fazën përgatitore të rishikimit të Strategjisë aktuale të Diasporës dhe hartimin e Strategjisë së re. Hartimi i dokumentit të ri strategjik do të ndjekë procedurën ligjore në zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Statusi: Në proces, fazë përgatitore.

Gjatë vitit 2024, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka paraqitur pranë MEPJ ndryshime në disa akte nënligjore diktuar kryesisht në nevojën për përditësimin e terminologjisë si rrjedhojë e suprimimit të Ministrit të Shtetit për Diasporën.